

# community

The New Apostolic Church around the world

02/2018/AI



## Rrugës nëpër Papua-Guinean e Re

Editoriali:  
Të festosh të dielën

Shërbesë fetare:  
Dhuratat hyjnore

Doktrina kishtare:  
Shpëtimi në Krijimin e Ri  
dhe betimi i Konfirmacionit

New Apostolic Church  
International



# Të festosh të dielën

Të dashur motra e vëllezër të besimit,

është një traditë bekuese që ne si të krishterë festojmë të dielën.

*Ne shpallim ringjalljen e Jezu Krishtit.*

Ne përjetojmë padrejtësi gjatë një jave, dëgjojmë gjëra të këqija në botë dhe pas kësaj ne mblidhemi të dielën e rrëfejmë: „Pavarësisht kësaj! Besojmë se Jezu Krishti është ringjallur. Ai e ka mposhtur vdekjen, të keqen, mëkatin. Atij i takon e drejta, ai e ka fjalën e fundit!“ Kjo është një mënyrë e mrekullueshme për të përfunduar javën dhe për të filluar një javë të re.

*Ne pranojmë ringjalljen e të vdekurve dhe shpresojmë për shndërrimin tonë.*

Ne presim ringjalljen e të vdekurve dhe transformimin e të gjallëve. Dhe çfarëdo që kemi përjetuar, çfarë do që kemi kaluar e parë: Shpresa jonë bazohet në rikthimin e Krishtit. Ne tregojmë qartë se i lëmë vendin e parë në jetën tonë më të rëndësishmit, sa herë që mbidhemi të dielën përherë e nga e para për shërbesë fetare.

*Ne i themi po së mirës.*

Njerëzit demonstrojnë për arsye të ndryshme edhe se duan të tregojnë: „Ne nuk jemi dakort me këtë apo atë gjë. Por ne e shohim ndryshe.“ Si të krishterë ne nuk pajtohemi me



Foto: NAC International

padrejtësinë, sundimin e së keqes. Dhe këtë ne e tregojmë po ashtu kur mblidhemi së bashku të dielave për shërbesë fetare. Ne besojmë në fitoren e së mirës mbi të keqen. Ne besojmë në ringjalljen e Jezu Krishtit dhe në rikthimin e tij.

Le ta festojmë kështu çdo të dielë.

Të fala të përzemërta, i juaji

Jean-Luc Schneider



Njëmbëdhjetë ditë ishte në udhëtim apostuli kryesor Jean-Luc Schneider nëpër Australi dhe Papua-Guinean e Re. Të enjten më 28 shtator ai udhëtoi për shërbesën fetare të Ditës së Sakrificës së madhe për në Kombikum.

Foto: NAC Australia



2 Korintasve 9,8:

*„Dhe Perëndia mund të bëjë që gjithë hiri të teprojë për ju, aq sa mbasi të keni gjithnjë mjaft në çdo gjë, t’ju teprojë për çfarëdo pune të mirë.“*

## Dhurata hyjnore

Të dashur motra e vëllezër, për mua është një gëzim i madh dhe një mëshirë e madhe që e përjetoj këtë shërbesë fetare në rrethin tuaj. Kjo është një shërbesë e veçantë fetare: Sot ne festojmë Ditën e sakrificës së madhe (festën e falenderimit për të korrat). Ne e falenderojmë Perëndinë për gjithshka që ai na ka dhuruar. E qartë është se Perëndia nuk e ka të nevojshme falenderimin dhe sakrificën tonë. Ai nuk është si ne njerëzit. Njerëzit që bëjnë ose japin diçka presin zakonisht një falenderim dhe trishtohen ose madje zemërohen kur askush nuk i falenderon ata. Por Perëndia nuk ka nevojë falenderimin tonë dhe as për sakrificën tonë. Arsyeja e vetme përse ai do të donte ndoshta një falenderim nga ne është, se ne do të merrnim edhe më shumë bekim përmes kësaj. Sepse çfarë bëjmë ne, kur përgatitemi për

falenderimin e të korrave? Ne numërojmë dhuratat e shumta të mëshirës së Perëndisë. Këtu ne bëhemi të ndërgjegjshëm për të gjitha ato që na ka dhuruar Ati ynë Qiellor. Ne na bëhet e qartë, se sa e madhërishme është mishira e tij ndaj nesh. Dhe ndërsa përgatitemi për Ditën e falenderimit për të korrat, ne bëhemi po ashtu të vetëdijshëm për pasurinë që kemi në Perëndinë. Bekimi qëndron në faktin që të kuptojmë, se sa të pasur jemi në Perëndinë. Dhe gëzimi është bekimi që ne sot marrim.

Apostuli këtu shkruan se Perëndia ka boll mëshirë për ne. Kur ne festojmë falenderimin e të korrave, ne pohojmë besimin tonë në Perëndinë, Atin. Ne besojmë që gjithshka vjen prej Perëndisë, Atit dhe që gjithshka është një mëshirë. Ne besojmë se jeta është tek Perëndia, pasi Perëndia na ka dhuruar jetë. Perëndia, Ati është zanafilla e të gjithë jetëve. Jeta vjen veçse prej Perëndisë dhe për këtë jemi mirënjohës. Ne njerëzit nuk mund ta bëjmë këtë. Jeta është e mundur veçse pasi e dhuron Perëndia, Krijuesi. Perëndia Ati, Krijuesi ka krijuar botën – natyrën – dhe ia besoi njeriut atë si dhuratë: Unë po ju jap ju natyrën, krijimin. Ajo është një dhuratë e Perëndisë. Ai na ka dhuruar krijimin e përsosur dhe ne jemi mirënjohës për këtë dhuratë.

Ai na dhuron ne akoma edhe më shumë, pasi ai e ruan krijimin e tij dhe jetën e krijuar. Perëndia Ati na jep shëndetin. Perëndia, Ati na jep forcën për të cilën kemi nevojë që të mund të punojmë dhe Perëndia e bekon edhe punën tonë. Shëndeti është një mëshirë, atë nuk mund ta fitosh. Mund t'ju them se njoh shumë njerëz, të cilët janë shumë më të mirë se unë. Ata nuk kanë bërë asgjë gabim, megjithatë janë të sëmurë. Pra unë jam i vetëdijshëm se shëndeti është me të vërtetë mëshirë. Atë nuk mundet që ta fitosh dhe për këtë arsye ne jemi mirënjohës. Perëndia na dhuron edhe aftësinë dhe forcën që na duhet për ta bërë punën tonë. Kjo po ashtu është një mëshirë. Ne jemi mirënjohës për këtë. Njoh njerëz që punojnë shumë e përsëri nuk kanë sukses. Nëse Perëndia nuk e bekon punën nuk ka si të ketë sukses. Dëshirojmë ta falenderojmë Perëndinë për atë që na ka dhuruar, shëndet, forcë dhe që bekon punën tonë.

*Perëndia na dhuron jo vetëm minimumin, porse mjaftueshëm me qëllim që të mund të bëjmë vepra të mira.*

Perëndia na ka dhuruar edhe njerëzit të cilët i kemi përreth. Është mëshirë të kesh një burrë ose grua. Është mëshirë e veçantë të kesh fëmijë. Madje është gjithashtu mëshirë të kesh edhe njerëz të tjerë përreth. Jeta jonë do të ishte shumë e vështirë nëse do të ishim vetëm. Shpesh ne jemi të varur prej ndihmës së të tjerëve. Është mëshirë që të jesh pjesë e një familjeje. Është mëshirë

Më shumë se 24.000 pjesëmarrës morën pjesë në shërbesën fetare në Papua-Guinean e Re.





e madhe të jesh pjesë e një populli dhe me dashurinë dhe mënçurinë e tij, Perëndia na ka dhënë një ligj: urdhërimet. Edhe kjo është mëshirë, pasi kur veprojmë sipas këtyre jeta midis nesh mund të jetë paqësore dhe e balancuar. Ne i jemi mirënjohës Perëndisë për urdhërimet, për ligjin e tij. Nëse ne i përmbahemi atyre, jeta jonë është e qetë dhe e ekuilibruar. Ne e falenderojmë Perëndinë për të gjitha ato që na ka dhuruar: krijimin, jetën, shëndetin, forcën dhe bekimin, për njerëzit të cilët janë rreth nesh dhe për urdhëresat hyjnore. Ne gjithashtu dimë dhe besojmë se Perëndia na ka dhënë mjaftueshëm, që të mundemi të bëjmë vepra të mira. Por ai nuk na dhuron veçse minimumin, por mjaftueshëm, me qëllim që të mund të bëjmë vepra të mira.

*Si fëmijë Perëndie ne besojmë se Perëndia na ka dhënë mjaftueshëm, në mënyrë që të mund të ndihmojmë edhe tjetrin.*

Por cilat janë këto vepra të mira? Me siguri që vepra e mirë e parë është falenderimi ynë ndaj Perëndisë. Ne e falenderojmë për të gjitha ato dhurata që na ka dhuruar. Ne besojmë se ai gjithmonë na dhuron mjaftueshëm që të mund

të themi faleminderit. Ne kemi gjithnjë mjaftueshëm me qëllim që t'i sjellim një sakrificë falenderuese Perëndisë: „Kjo të takon ty, pasi ti ishe ai që na bekoje.“

Motra e vëllezër, pikërisht një besim të fortë të tillë kërkojmë të kemi. Perëndia na dhuron gjithnjë mjaftueshëm që ne të mund të shprehim mirënjohjen

tonë nëpërmjet sakrificës sonë. Ne kemi gjithmonë mjaftueshëm që të bëjmë një vepër të mirë dhe të ndajmë me të afërmin tonë. Ne mund t'ja lejojmë vetes që të mos mendojmë veç për vete. Ai na ka dhuruar krijimin e tij.

Shumë besimtarë kishin udhëtuar gati për rreth shtatë ditë më këmbë. Për t'u kujdesur për ta, bashkësitë prej zonës së Kombikutit ishin kujdesur shumë kohë më parë për ngritjen e vëndeve ku ata do të hanin e do të flinin.



Në marrëdhënie me natyrën, ne mund t'ja lejojmë vetes të mendojmë jo vetëm për të afërmin tonë, por edhe për brezin e ardhshëm. Ne besojmë se ka për të gjithë mjaftueshëm. Po ashtu ne duam të jemi të kujdesshëm edhe me natyrën, si dhe me burimet natyrore e të mos mendojmë veç për vete. Madje edhe atëherë kur ne nuk kemi shumë, prapëseprapë ne besojmë se Perëndia na ka dhënë mjaftueshëm që të mund ta ndihmojmë të afërmin tonë në vështirësi.

Njoh shumë njerëz, të cilët nuk pajtohen me këtë. Ata ankohen: „Jemi kaq të varfër. Nuk kemi asgjë.“ Por ne si fëmijë Perëndie besojmë se Perëndia na ka dhënë aq sa të mund ta ndihmojmë tjetrin. Ky është besimi ynë. Ne besojmë se Perëndia na ka dhuruar mjaft për të jetuar dhe se mund ta përballojmë të ndjekim urdhërimet e tija. Ne nuk detyrohemi të bëjmë një mëkat që të marrim atë çfarë na duhet. Shumë njerëz mendojnë: Nuk kam mjaft për të jetuar, kështu po bëj vjedhje. Ata kanë humbur çdo ndershmëri, pasi duan më shumë. Ky nuk është besimi ynë. Ne jemi të kënaqur me atë çfarë mund të fitojmë duke ndjekur urdhëresat hyjnore. Ne besojmë se Perëndia na ka dhënë mjaft me qëllim që të mund t'i ndjekim pas urdhëresat e tija.

Ne madje besojmë se kemi aq shumë sa të mund të përballojmë të kujdesemi për shpirtin tonë. Shumë njerëz thonë: „Kisha juaj më pëlqen, por nuk kam kokë për të shkuar në kishë. E dini, më duhet të punoj, ushqej familjen time.“ Ne besojmë se Perëndia na siguron gjithshka që na nevojitet që të mund të kujdesemi për shpirtin tonë dhe të mos „ndëshkohemi“ meqë shkojmë në kishë. Ne mund t'ja lejojmë vetes që të shkojmë në shërbesa fetare e të kujdesemi për shpirtin tonë pa na u krijuar përmes kësaj mungesa në jetën e përditshme.

Perëndia na ka dhuruar shumë. Prej mëshirës na ka dhuruar aq me shumicë, sa që mund të jemi mirënjohës, mund të mendojmë për të tjerët e mund t'i ndihmojmë ata. Ai na ka dhuruar aq me shumicë sa që mund t'i mbajmë urdhërimet e tija dhe mund të kujdesemi për shpirtin tonë.

Ne i jemi edhe Jezu Krishtit mirënjohës. I jemi mirënjohës Shpirtit të shenjtë. Jezu Krishti, Biri i Perëndisë na ka bërë një dhuratë tejet të veçantë, një mëshirë të veçantë. Ai dha jetën e tij, që ne të na jepet jeta e përvetshme. Falë sakrificës së tij u bë e mundur që ne të mundemi të kemi bashkësi të përvetshme me Perëndinë dhe mund të hyjmë

Ulur në altar: ndihmës apostuli i distriktit Edy Isnugroho, ndihmës apostuli i distriktit Peter Schulte dhe apostuli i distriktit Andrew Andersen



në Mbretërinë e tij. Askush tjetër nuk mund ta mposhte vdekjen dhe djallin. Dhe të them të vërtetën ne nuk e meritojmë këtë. Kur Jezusi dha jetën e tij për mua, unë as që nuk kisha lindur. Askush nuk e dinte se do të ekzistojë ndonjëherë. Por ai më deshi aq shumë sa që vdiq për mua. Çfarë mëshire! Ne nuk kemi bërë asgjë për këtë dhe përsëri ai na ka dhënë gjithshça. Ne jemi mirënjohës për sakrificën e Jezusit dhe për jetën e përjetshme.

Ne i jemi mirënjohës Shpirtit të shenjtë, pasi pa Shpirtin e shenjtë ne edhe pse do të mund ta lexonim historinë e Jezusit në Bibël, ajo nuk do të na shërbente për asgjë. Pasi nëpërmjet veprimit të Shpirtit të shenjtë, ne na jepet jetë e përjetshme prej fjalës së Perëndisë dhe sakramenteve. Shpirti i shenjtë na ndihmon, që do të thotë, se ai na e bën të mundur fitimin e jetës së përjetshme. Dhe ai e ruan këtë jetë me anë të fjalës së tij, me anë të sakramenteve. Prandaj është është një mëshirë e veçantë që ne e njohim Jezu Krishtin dhe që mund ta ndjekim pas atë. Ne i jemi mirënjohës Shpirtit të shenjtë që na dhuron forcën për ta ndjekur pas Jezu Krishtin.

Perëndia na ka dhuruar edhe fëmijë të tjerë Perëndie. Ne të gjithë jemi pjesë e Kishës së Krishtit. Mendoj se jeni dakort me mua: Do të ishte shumë e vështirë të qëndronim besnik, nëse do të ishim vetëm. Ne jemi kaq mirënjohës që kemi kaq shumë motra e vëllezër që na ndihmojnë, të cilët lutën për ne dhe të cilët luftojnë me ne dhe për ne.

Me anë të Shpirtit të shenjtë ai na ka dhënë edhe një urdhër të veçantë. E njihni urdhrin e Jezu Krishtit? Rezultati dhe sukcesi nuk janë vendimtarë për të. E vetmja çfarë është e rëndësishme për të është përpjekja dhe dashuria jonë. Do të ishte e tmerrshme nëse për Perëndinë do të kishin rëndësi veç sukseset tona. Mendoj se atëherë do të ishim shumë më pak sot. Të paktën unë nuk do të isha këtu, pasi i kam premtuar shumë gjëra Perëndisë – për të përballuar këtë apo atë, për të lënë këtë apo atë dhe për të bërë një gjë ose një tjetër për të –, dhe nuk e kam

arritur. Nuk isha i sukseshëm. Po falë Perëndisë ai nuk e vlerëson këtë. Vendimtare për të është vetëm dashuria dhe përkushtimi ynë ndaj tij, përpjekja jonë. Dhe prandaj jemi kaq mirënjohës për këtë ligj të Krishtit. Ai na ka dhënë urdhëresën e dashurisë, të faljes. Përndryshe ne nuk do të kishim një bashkësi me njëri-tjetrin. Kjo është urdhëresa që Perëndia ia dha popullit të tij. Për këtë arsye është për ne e mundur të mbetemi së bashku e të jemi një.

Këto janë dhuratat hyjnore. Prej mëshirës ai na dhuroi jetë të përjetshme, të cilën ai e ruan me anë të fjalës së tij dhe sakramenteve. Ai na ka dhuruar mëshirën për të qenë pjesë e bashkësisë së fëmijëve të Perëndisë dhe ai na ka dhënë urdhëresën e mëshirës, të dashurisë e të faljes. Dhe ai na ka dhuruar kaq më bollëk, sa që ne mund të bëjmë vepra të mira. Ai na ka dhuruar kaq shumë, sa që mund të heqim dorë prej të gjitha atyre që nuk janë të pëlqyeshme për Perëndinë. Ne nuk na duhet të ndjekim pas djallin. Ai na ka dhënë aq sa mund të bëjmë pa mendimet e opinionet tona, ne mund të pranojmë mendimet e Jezusit. Ne kemi marrë kaq shumë prej Jezusit, sa që nuk na kushton shumë të themi: „Ok, ti nuk je tërësisht dakort me mua. Po heq dorë prej idesë sime dhe po mendoj por si ti.“ Kur Jezusi na thotë: „Mendime e tua nuk më pëlqejnë“, atëherë ne themi: „Ok, Jezus, unë do të ndryshoj.“

Ne mund t'ja lejojmë këtë vetes, pasi jemi kaq të pasur: Lavdinë, të cilën ai tashmë na e ka dhuruar dhe lavdinë, të cilën ai do të na e japë – e pikërisht bashkësinë e



përjetshme me Perëndinë si dhe për t'u bërë si Jezusi. Kjo është madhështore, që ne në tokë mundemi t'i përballojmë vuajtjet e mundemi t'i shërbejmë Zotit e fqinjët tonë – njëherë vetëm sepse e dimë që ia vlen të vuash për Krishtin e me Krishtin. Ia vlen t'i shërbejmë Zotit e tjetrit. Ia vlen të përfshihesh në punën e Perëndisë: Shpërblimi është bashkësia e përjetshme me Krishtin. Lavdia, në të cilën do të hyjmë është kaq madhështore, saqë nuk do të mendojmë më fare për vuajtjet e shërbimin tonë. Madje edhe ata, të cilët kanë vuajtur gjatë gjithë jetës së tyre nuk do të mendojnë më për atë, kur të jenë bashkë me Krishtin në Mbretërinë e tij. Perëndia na ofron pra shumë mundësi, me qëllim që ne të mund të shërbejmë e nëse duhet, edhe të mund të durojmë vuajtje. Ky është një premtim i mrekullueshëm, të cilin Perëndia na ka dhënë. Perëndia na ka dhënë mjaftueshëm që ne të mund të bëhemi shërbëtorë në mbretërinë e paqes. Përfytyrohemi njëherë këtë! Perëndia na ka dhënë ty e mua aq shumë edhe pse jemi mëkatë të dobët e të papërsosur, që ne të mund t'i shërbejmë Krishtit në mbretërinë e paqes. Dhe pastaj ne jemi për të gjithë popujt një vegël në dorën e Perëndisë. Perëndia na ka dhënë që sot aq shumë, saqë të mund ta ndajmë me të afërmin tonë pasurinë tonë shpirtërore. Dhe ne tanimë që sot kemi aq sa të mund t'i ndajmë me të tjerët besimin e dhuratat e Perëndisë. Jo së pari në mbretërinë e paqes, por që tani.

Këto janë disa shembuj të dhuratave, të cilat ne kemi marrë prej Birit të Perëndisë e Shpirtit të shenjtë. Për këtë gjë ne jemi kaq mirënjohës. Ne duam të bëjmë vepra të mira me anë të kësaj. Ne duam të heqim dorë nga çdo mendim, që nuk është i pëlqyeshëm për Perëndinë. Ne duam t'i shërbejmë Perëndisë. Ne kemi mjaftueshëm për ta bërë këtë. Ne duam t'i ndajmë këto dhurata me të afërmin dhe të shpallim mësimin e Jezusit. Në rikthimin e Krishtit ne do t'i shërbejmë atij në mbretërinë e Perëndisë dhe do të jemi një vegël për të gjithë popujt. Kemi kaq shumë arsye për ta lavdëruar Perëndinë dhe për ta falenderuar atë. Dhe kjo mirënjohje është edhe një bekim për të gjithë ne.

## MENDIME KYÇE

Pasuria e mëshirës na bën të aftë për të bërë mirësi në tokë e për të qenë shërbëtorë të vërtetë të Zotit.



# Do të doja të kisha mjaftueshëm fjalë për këtë!

Po si do të jetë vallë në mbretërinë e ardhshme të Perëndisë? Për këtë nuk ka fjalë thotë apostuli kryesor. Por ajo çfarë shkruhet në Bibël në lidhje me këtë mund të na ndihmonte për të mësuar së kuptuari.

Foto: INA Brasil



„Perëndia dëshiron ta ndajë me ne lavdinë e tij“ – ky ishte mesazhi i qartë që apostuli kryesor Jean-Luc Schneider i drejtoi bashkësisë në Natal (Brasil) në shërbesën e tij fetare më 6 gusht 2017.

## Jeruzalemi, një figurë e mbretërisë së Perëndisë

„Sot ne e kuptojmë këtë tekst lidhur me Jezu Krishtin“, filloi predikimin e tij apostuli kryesor. Jeruzalemi është një figurë në lidhje me kishën. Bëhet fjalë për Jeruzalemin qiellor, bashkësinë e besimtarëve. „Dhe ndaj kësaj bashkësie flet Perëndia: Unë do të çliroj prej së keqes dhe unë do të udhëheq edhe më shumë njerëz drejt Jeruzalemit.“

- Jezusi e mposhti ferrin dhe vdekjen: „Këtë fitore ai do ta ndajë bashkë me ne. Ai do të na çlirojë përfundimisht prej së keqes e vdekjes. Neve nuk do të na duhet të kemi të bëjmë kurrë më me të keqen. Kur të vijë Jezusi, ne do të marrim pjesë prej fitores së tij.“
- Jezusi mori trupin e ringjalljes: „Me këtë trup ringjalljeje ai hyri si i parë në mbretërinë e Perëndisë. Atje ai është i pari ndër shumë vëllezër dhe do ta ndajë këtë bashkë me ne.“
- Ne do të jemi pjesë e lavdisë së Perëndisë: „Do të doja të kisha mjaftueshëm fjalë për ta përshkruar këtë. Por nuk ka fjalë. Për ta përfytyruar mund të na ndihmoj një mendim: Kjo lavdi do të jetë aq e madhe dhe e

mrekullueshme, sa që do të kemi çdo ditë një arsye të re në përjetësi për ta falenderuar dhe lavdëruar Perëndinë!“

## Jo vetëm nesër por që sot

Megjithatë, kështu apostuli kryesor, ne nuk do të na duhej me patjetër të prisnim derisa të vijë Zoti. „Ne që sot mund të përjetojmë një shijim paraprak të kësaj. Në shërbesë fetare ne mund të përjetojmë që Perëndia na dhuron mëshirë. Ne që sot mund të shijojmë prej meritës së Jezu Krishtit.“ Dhe këtë në fakt duhet ta vëjnë re njerëzit që na rrethojnë, paralajmëroi ai.

## E ardhmja – e tashmja – detyra

Së fundmi Jezusi vdiq për të gjithë njerëzit dhe për këtë arsye sakrificë e tij është e vlefshme për të gjithë. Ai do të udhëheqë edhe më shumë njerëz drejt qytetit të tij. Prandaj për ata, të cilët e kanë tashmë një vend atje vlen: „Shkoni drejt tyre, tregojani rrugën, largoni gurët prej rrugës së tyre.“ Kjo është detyra jonë: për t’ju treguar rrugën atyre, me anë të sjelljes sonë, dëshmisë, fjalës dhe veprës.

Apostuli kryesor Schneider në mbyllje: „Ne duhet të jemi udhërrëfyes për njerëzit. Kjo është e ardhmja jonë – kjo është e tashmja jonë – kjo është detyra jonë.“

# I Në udhën e kthimit për në shtëpi

Jezusi shkoi për të përgatitur një vend. Surpriza numër një: Ky vend është me kohë gati. Surpriza numër dy: Njerëzimi ka qenë njëherë atje. Ngrihet pyetja: Si do të kthehet përsëri në shtëpi?

Më shumë se 114.000 pjesëmarrës përjetuan shërbesën fetare me apostulin kryesor Jean-Luc Schneider më 15 tetor 2017 në bashkësinë e Claremont në Cape Town (Afrika e Jugut) – kryesisht nëpërmjet transmetimit vizual.

## Të shikosh më tej, të shohësh të gjithë pamjen

Kur Jezusi i tha këto fjalë, ai ishte bashkë me nxënësit dhe përshkroi atë çfarë e priste – tradhëti, vuajtje, ankth. Nxënësit ishin pa fjalë, por Jezusi jua hapi vështrimin: Ai do të shkojë tek Ati i tij. Ky është qëllimi, shpjegoi apostuli kryesor. „Ai dëshironte që ata ta njihnin fundin e historisë.“

„Kjo vlen edhe për ne.“ Pasi: „Ne e dimë se duhet të kalojmë nëpër vuajtje, ne e dimë se duhet të mbajmë barra shumë të rënda.“ Por: Perëndia nuk çon në trishtim dhe vështirësi, porse përmes trishtimit dhe vështirësive në mbretërinë e tij. „Le ta kemi këtë shikim kaq të gjerë, le të shohim më tej me Shpirtin e shenjtë.“

## Aty ku njeriu duhet të kish qenë gjithmonë

Jezusi shkon për të përgatitur një vend. Po çfarë vendi është ky? „Ky është vendi ku njeriu duhet të kish qenë gjithmonë.“ Pasi Perëndia i ka krijuar njerëzit për të qenë të bashkuar me të. Por përmes rënies në mëkat vendi përkrah tij humbi.



Pas 44 vjetësh detyre, prej të cilave 17 vjet si apostul, apostuli John G. Stephens del në pension



Jezusi erdhi në tokë për t'i përgatitur përsëri këto vende: „Përmes sakrificës së tij deri në vdekje dhe ringjalljes së tij ai i krijoi mundësinë njeriut për të hyrë në mbretërinë e paqes“, theksoi drejtuesi i kishës. „Ky vend është me kohë i përgatitur. Secili prej nesh e ka këtë vend në qiell. Kjo është përfunduar. Vendi është gati dhe pret vetëm për ne.“

## Jo vetëm të qëndrojmë, por të shkojmë

Rruga për atje është e qartë: „Unë jam rruga“, thotë Jezusi. „Le ta ecim këtë rrugë“, tha apostuli kryesor – rrugën, të cilën ka vendosur Jezusi:

- Rruga e besimit: „Edhe unë kështu tipi jam: Dua të kuptoj, më duhen prova. Por kur bëhet fjalë për Jezu Krishtin dhe punën e tij, atëherë më duhet të pranoj se nuk mund ta kuptoj atë me mendje. Le të ecim përpara – në besim.“
- Rruga e sakramenteve: Kush kërkon të hyjë në mbretërinë e Perëndisë, ai duhet të lindë prej Ujit dhe Shpirtit. Dhe kush kërkon të ringjallet, ai duhet të shijojë trupin dhe gjakun e Jezusit. „Këtë nuk e vendosi asnjë kishë. Ishte vetë Jezusi.“
- Rruga e bindjes: „Ai që kërkon ta ndjeki pas Jezusit duhet të mbajë urdhëresat e tija. Edhe atëherë kur është e vështirë, ne vazhdojmë të mbetemi në këtë rrugë. Është rruga e vetme për tek Jezusi.“
- Rruga e vetëmohimit: „Jezusi dëshiron më shumë se veçse njerëz të bindur. Ai dëshiron që ne të bëhemi si ai, që mendimet e tija të bëhen mendimet tona. A jemi ne ende drejt rrugës së ndryshimit?“
- Rruga e të qenurit një: „Ne duhet të mësojmë të bëhemi një në Krisht, pasi ai nuk do të vijë për të marrë njerëz

veç e veç. Ai dëshiron të marrë një popull, i cili është një.“

„Nuk është e mjaftueshme veçse të mbetesh në këtë rrugë. Ne duhet të ecim gjithashtu përpara“, kështu në mbyllje apostuli kryesor Schneider: „Jezusi do të vijë përsëri. Ai na del përpara, pasi e di se ne nuk mund ta bëjmë vetëm këtë. Dhe kur unë lutem: ‚Eja të lutem, Zoti Jezus!‘ Atëherë unë mund të dëgjojë në shpirtin tim se si ai përgjigjet: ‚Po, unë do të vijë, por eja edhe ti. Mos qëndroni në vend, vazhdoni të ecni në këtë rrugë.‘“

## MENDIME KYÇE

*Gjoni 14,3.4:*

**„Dhe kur të shkoj e t’ju përgatis vendin, do të kthehem dhe do t’ju marr pranë meje, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju. Ju e dini se ku po shkoj dhe e njihni edhe udhën.“**

Jezusi përmes sakrificës dhe ringjalljes së tij na ka përgatitur një vend tek Perëndia. Ai do të kthehet përsëri për të marrë pranë vetes ata, që i përmbushin kërkesat e tija.

## JEZUSI VIHET NE PROVE

MATEU 4,1-11

*Jezusi lejon të pagëzohet prej Gjonit, dhe pas kësaj Shpirti, Fryma e Perëndisë bie mbi të. Më pas Jezusi gjëndet në shkretëtirë. Aty djalli përpiqet ta bindë për të bërë atë që i thotë, por Jezusi nuk i bindet.*

Pasi Jezusi u pagëzua në Jordan prej Gjon Pagëzorit, Fryma e Perëndisë e dërgon atë në shkretëtirë. Aty ai vihet në provë nga djalli. Jezusi argjeron për dyzet ditë dhe dyzet netë. Ai nuk ha asgjë, për këtë arsye ka uri.

Aty vjen djalli dhe i thotë: „Nëse je Biri i Perëndisë, atëherë thjesht thuaj që këta gurë të shndërrohen në bukë.“

Jezu i përgjigjet: „Në shkrim thuhet: ‚Njeriu nuk rron vetëm me bukë, porse nga çdo fjalë që vjen nga goja e Perëndisë.‘“

Aty djalli e çon për në Jeruzalem dhe e dërgon në majë të Tempullit.


Ai i thotë Jezusit: „Nëse je Biri i Perëndisë, atëherë hidhu pra poshtë. Në shkrim thuhet: ‚Ai do t’i urdhërojë engjëjt e tij që të të mbajnë në duar, me qëllim që këmba jote të mos prek në ndonjë gur.‘“

Jezusi i përgjigjet: „Në shkrim thuhet gjithashtu: ‚Mos e tundo Zotin, Perëndinë tënd.‘“

Pastaj djalli e dërgon mbi një mal shumë të lartë dhe i tregon të gjitha pasuritë dhe madhështitë e kësaj bote. Ai i thotë Jezusit: „Të gjithë këtë unë dua të ta japë ty, nëse bie përmbys para meje dhe më adhuron mua.“

Jezusi i përgjigjet:  
„Largohu prej meje satan,  
pasi në shkrim thuhet:  
,Ti duhet të adhurosh  
Perëndinë dhe t'i shërbesh  
vetëm atij.““

Aty djalli largohet prej tij.  
Engjëjt vijnë tek Jezusi dhe  
i shërbejnë.



## PER VIZITË TE SINTIA NË NXHAMENA (ÇAD)

Mirëdita, unë quhem Sintia, jam dymbëdhjetë vjeçe. Para një viti, në janar të 2017, apostuli kryesor Jean-Luc Schneider mbajti tre shërbesa fetare në Çad; njërën prej tyre në kryeqytetin Nxhamena aty ku unë jetoj. Mua m'u lejua ta përshëndesja me një tufë me lule.



Çadi është një vend në zemër të Afrikës. Veriu është shumë i thatë, aty gjenden shkretëtira e Sahara-së dhe malet vullkanike. Më në jug shtrihet Zona e Sahelit, një gjysëm shkretëtirë. Në jug të vendit ka pyje dhe savana të lagështa. Kjo është shtëpia e shumë prej kafshëve.



Ujitja e vendit bëhet prej dy lumenjve shumë të mëdhenj, prej Sharit dhe Logones. Në Nxhamena ata bashkohen bashkë dhe rrjedhin pas kësaj në liqenin e Çadit. Ne banojmë në periferi – nëse duam të shkojmë në qytet ne duhet të përshkojmë Sharin.

A mund t'ju prezantoj familjen time? Në rreshtin e pasëm ju shihni mamanë time Sabine, mua, kushërirën time Karolina dhe tezen time Félicité. Përpara qëndron kushërimi im Frédéric me gjyshin tim dhe kushërija ime Anastasia me gjyshen time. Kristiani, babai im nuk është në këtë foto.



Mamaja ime punon si infermiere dhe udhëton shpesh. Për këtë arsye unë jetoj me kushërirën time Karolinë tek teza ime. Ajo na do shumë dhe na ndihmon për detyrat e shtëpisë. Së bashku me Karolinën unë shkoj në klasë të pestë. Në mëngjes shkolla fillon në orën 7.30 dhe mbaron çdo ditë në orën 17. Të shtunave kemi pushim. Në Çad kemi dy gjuhë zyrtare: frëngjishten dhe arabishten. Ah po, për pak e harrova, krahas meje qëndron Patience, qeni ynë.

Unë jam që prej lindjes apostolike e re. Gjyshja ime Odile është shumë aktive në bashkësi. Gjyshi im quhet Dakoua, ai është një apostul. Ai më inkurajon që të përfshihem në korr si dhe në shkollën e së dielës. Në foto shihni nxënësit e shkollës të së dielës prej bashkësisë sonë, prindërit e tyre dhe mësuesin tonë. Në total, ne jemi afërsisht 50 motra e vëllezër në shërbesë fetare.



Në bashkësinë tonë në Toukra korrin e shkollës të së dielës e dirigjoj unë. Kjo më jep një gëzim të madh. Ne bëjmë tre herë në javë prova. Nëse bëhem ndonjëherë vonë, fëmijët vijnë tek unë në shtëpi dhe pyesin se kur do të fillojë më në fund prova. Përveç kësaj Karolina dhe unë i biem fyellit. Ndhmësi i apostulit të distriktit John Sobottka, i ka përfshirë këto vegla muzikore në bashkësitë apostolike të reja të Çadit.





Photo: ©Helen Hotson - fotolia.com

# Shpëtimi në Krijimin e Ri

Më pranë, o Zot, tek ti: Çfarë roli luan bashkësia nuse në Lavdinë e përjetshme? A ka ajo një status, një vend të veçantë, a është ajo më pranë? Përgjigjja del shumë qartë.

Katekizmi e bën të qartë, që Kisha Apostolike e Re e pranon se beson në rikthimin e Jezu Krishtit, gjë që është formuluar që në artikujt e besimit të kishës mëmë. Ne besojmë, që Jezu Krishti do të vijë përsëri në (forcë dhe) në Lavdinë e tij, për të gjykuar të gjallë e të vdekur (Apostolikumi KNK-PP 34), dhe „ne e presim jetën e botës së ardhshme“ (Dëshmimi i Nizea-Konstandinopolit KNK-PP 35).

Kur ne flasim për rikthimin e Jezusit, në fillim kemi parasysh ngjitjen drejt tij të të paralindurve. Rreth kësaj përqëndrohet edhe puna e postit të apostujve, në rradhë të parë përgatitja për këtë ngjarje ishte edhe një nga shkaqet

për ta rizënë edhe një herë me persona atë post të apostujve në shekullin 19-të. E megjithatë është e rëndësishme që të mos humbasim vështrimin mbi planin e plotë hyjnor të shpëtimit.

## Zoti duhet të jetë gjithçka mbi çdo gjë

Vepra e Perëndisë e bën të mundur, që njerëzimi në të gjitha kohërat të ketë pasur mundësi të fitojë shpëtimin. Të paralindurit, të cilët Perëndia do t'i marrë drejt vetes, do të arrihet së bashku me ata njerëz, të cilët për hir të Krishtit dhanë jetën e tyre gjatë kohës së turbullt e të





mundimshme. Gjatë mijëvjeçarit të mbretërisë së paqes shpëtimi do t'ju ofrohet të gjithë njerëzve. Të gjithë ata, të cilët do të vendosin atëhere për Krishtin, do t'u garantohej rruga drejt Krijimit të Ri dhe ata do të kenë një jetë të plotë hyjnore. Pasi Perëndia do të jetë „gjithçka mbi çdo gjë“ (1 Korintasve 15,28). Njerëzit do të jetojnë atëhere në një bashkim të përhershëm me Zotin. Paqja e gëzimi do të sundojë përjetësisht, pasi gjithshka – qielli i ri, toka e re dhe ata, të cilët do të banojnë mbi të – do të jenë në mirëkuptim e harmoni me vullnetin e Perëndisë.

## Tabllotë, shëmbëlltyrat për të ardhmen

Jezu Krishti përdorte shëmbëlltyra të ndryshme kur flistë për shpëtimin. Shëmbëlltyra e groshëve (parave të vogla) (Luka19) bënte të qartë, se kishte një lloj „Hierarkie“ në marrjen e shpëtimit: mbreti i premtos shërbëtorit të parë pushtet mbi dhjetë qytete dhe të dytit i jep pushtet mbi pesë.

Por shëmbëlltyra nuk tregojnë nga ana tematike një hierarki, por nxjerr në pah një qëndrim, i cili është i rëndësishëm për marrjen e shpëtimit. Kur Jezu Krishti flet për „pasjen pushtet“, atëhere e bën për të sqaruar, se besimtarët

- do të sundojnë së bashku me të, me fjalë të tjera, do të ndajnë me të Lavdinë e tij;
- do të marrin një zonë pune, e cila do të thotë, se ata do t'i shërbejnë edhe më tutje atij.

## Jo hierarki në marrjen e shpëtimit

Ngrihet pyetja, cilin vend do të zërë, do të ketë bashkësia nuse në Krijimin e ri. Zbulesa e Gjonit flet për „Jeruzalemin e ri“, për shërbëtorët, që i shërbejnë Zotit dhe që do të sundojnë me të.

Këto janë shëmbëlltyra të bashkimit të njerëzve me Perëndinë dhe ndërmjet njëri-tjetrit. Të flasësh se do të ketë dy lloj kategorish shpëtimi në Krijimin e ri sipas informacionit të Zbulesës, nuk është bindëse. A mund të mendojmë me të vërtetë se në Krijimin e ri do të ketë dy lloj bashkimesh me Perëndinë? Pra që ata, të cilët do të marrin pjesë në rikthimin e Krishtit, do të kenë një vend të veçantë në Krijimin e ri?

Një imagjinatë e tillë nuk përputhet me dëshminë e Testamentit të Ri. Kur Zoti është gjithshka mbi çdo gjë ose kur është në çdo gjë, atëhere nuk mund të ketë diçka përtej tij. Nuk ka asgjë, që mund të jetë më e madhe sesa plotësia e jetës së përhershme, se sa bashkimi i përjetshëm me Perëndinë, me Trininë e tij në lavdinë dhe në dritën e tij!

## Për të gjithë: Bashkim me Perëndinë

Dashuria ndaj Perëndisë nuk mund të jetë e shkëputur nga dashuria ndaj tjetrit. Jezusi priste nga të vetët, që ta donin tjetrin, ashtu siç i donte ai ata. Ai, i Përsosuri, është gati të ndajë me ne mëkatarët trashëgiminë e tij, pasi na do. Nëse ne do të duam po ashtu si Jezusi, nuk mërzhitemi kur ai, Zoti, i jep edhe tjetrit po atë që ka parashikuar për ne ...

Të tjerë kanë frikë, se mos i vihet pikëpyetje të zgjedhurës sonë, kur thuhet se Perëndia do t'u hapë të gjithëve mundësi në Krijimin e ri, për të jetuar në një bashkim të përhershëm me të. Nuk duhet të harrojmë, që nuk u zgjedhëm për t'u shpëtuar të vetëm, porse për të pasë mundësi që ta gjejmë shpëtimin të parët. Të mos harrojmë gjithashtu, se zgjedhja jonë është në rradhë të parë një thirrje: Neve jemi thirrur për të shërbyer, për të shpallur bamirësitë e Perëndisë dhe për të dëshmuar – sot dhe në mbretërinë mijëvjeçare të paqes. Këtë shërbim duam ta kryejmë me gëzim, me qëllim që të falenderojmë Perëndinë për mëshirën e tij, dhe jo për të pritur shpërblimin e tij.



Foto: Oliver Rütten

# Kuptimi, rëndësia e betimit të Konfirmacionit

Filloi me pagëzimin: Betimi i Konfirmacionit të Kishës Apostolike të Re është shumë më i vjetër se 1700 vjet. Nga rrjedh, nga vjen ky tekst dhe çfarë do të thotë ai?

Betimi i sotëm i konfirmacionit gjendet në një tekst, i cili është përpiluar në fillimet e shek të 3-të pas Krishtit. Ky tekst njihet si „traditio apostolica“, i cili i përkthyer nga latinishtja do të thotë „traditë apostolike“. Kjo „traditë apostolike“ i dedikohet të shkolluarit Hippolyt nga Roma. „Tradita apostolike“ është krahas „Didache“, „doktrinës së 12 Apostujve“ të shek të 2-të, burimi më i rëndësishëm për jetën në bashkësi dhe për rregullin e shërbesës fetare të bashkësive të para të krishtera.

Teksti i betimit tonë të konfirmacionit gjendet tek „tradita apostolike“ nën kushtet e pagëzimit. Pra, më parë ka qenë

një betim për pagëzim, të cilin e bënin të rriturit, të cilët ishin në anën e Krishtit dhe që kishin përfunduar mësimin e pagëzimit. Nëse pagëzoheshin fëmijë, këtë betim e bënin prindërit ose një pjesëtar tjetër i familjes në vend të tyre.

Në kishën apostolike të re, ky betim i vjetër i pagëzimit bëhet, përdoret për betimin e konfirmacionit. Në këtë mënyrë, ai betim i cili bëhej prej prindërve në emër të fëmijëve, kryhet apo konfirmohet nga vetë Konfirmandët.

Termi Konfirmacion vjen nga fjala latine „confirmatio“, i cili do të thotë përforcoj, lidh fort. Lidhet fort apo

përforcohet nëpërmjet konfirmacionit ajo „Po“ e marrjes së shenjtërimeve dhe për një jetë të re në ndjekjen pas të Krishtit.

Betimi i konfirmacionit përbëhet nga dy „Formula“: një formulë kundërshtuese dhe një tjetër konfirmuese, përforcuese. Brenda tyre ka vendime bazë, që i përkasin të qenurit i krishterë, si p.sh.: „Jo“ ndaj së keqes, së ligut është kundërshtimi që i bëhet djallit, dhe „Po“-ja ndaj Trinisë së Perëndisë do të thotë dorëzimi tek Perëndia, si Zoti i jetës sonë.

Formula kundërshtuese është: „Unë i them jo djallit, gjithë punës dhe qenies së tij“ (në original shkruhet: „Unë të kundërshtoj ty, o djall, Satan, gjithë shërbimit tënd [lat.: servitio] dhe gjithë veprave të tua.“)

Mbas kësaj formule qëndron mendimi, që konfirmandi, me vullnet të lirë largohet nga e keqja, e cila ka marrë veshjen e djallit – e pikërisht që prej asaj dite e më tutje merr përgjegjësinë personale! Shembuj të veprave të djallit janë tundimet për t'u larguar nga Perëndia e madje edhe për t'u vënë kundra tij, për t'i shërbyer idhujve, mosvlerësimi i sakrificës së Jezusit, mosvlerësimi i vullnetit të Perëndisë, mosdashuria apo një pushtet i tepruar e i paskrupullt. E pikërisht prej të gjitha këtyre dëshëron të distancohet ai njeri, i cili e thotë, e konfirmon plot me besim këtë formulë.

Formula kundërshtuese nuk do të thotë, se njeriu tashmë është pa asnjë mëkat dhe se ai do të arrijë tashmë të jetë jashtë influencës të së ligut. Me anë të saj shprehet shumë më tepër, se Konfirmandi di më shumë rreth tendencës për

të rënë në mëkat dhe se ai nuk dëshiron të bëjë një jetë në krahun e së keqes dhe në kundërshtim me Zotin. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që konfirmandi të ketë shoqërinë, praninë e Shpirtit të Shenjtë, dhuntitë e të cilit tashmë konfirmandi i ka marrë. Njeriu nuk është kurrë në gjendje ta mbajë betimin e bërë vetëm nëpërmjet forcës së vet.

Mbas formulës kundërshtuese vjen formula konfirmuese, ajo është: „Unë ... të jepem ty, o Trini e Perëndisë, Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë në besim, bindje, përulje me anë të pohimit serioz: Se do të mbetem besnik deri në fund të jetës.“

Në rradhë të parë, ai që e thotë këtë formulë bën të qartë, se e pranon Trininë e Perëndisë si Zotin e vet, i cili do të

përcaktojë edhe vetë jetën e tij. „Besimi“ dhe „përulja“ janë aspektet kryesore të një jete me Zotin. Besim ndaj Perëndisë do të thotë, të kesh mirëbesim tek ai. „Të jesh i përulur“ ndaj vullnetit të Perëndisë është një konsekuencë, pasojë bazë e besimit.

Së fundi bëhet fjalë për një „pohim serioz“. Me anë të tij shprehet fakti se, formula e pohimit, konfirmimit nuk është diçka e thënë ashtu lehtë, joseriozisht, porse njeriu duhet të merret seriozisht me plotësimin, mbajtjen e saj. Ai pohon se do të bëjë

një jetë konsekuente sipas vullnetit të Perëndisë, pra do t'i mbetet atij besnik deri në fund. Ndërkohë që besnikëria, të cilën konfirmandi premtion, nuk është asgjë tjetër veçse një përgjigje e besnikërisë së Perëndisë, e cila shprehet në një dhuratë të shenjtërimeve dhe në shoqërimin, praninë mbrojtëse të tij

*„Unë i them jo djallit dhe gjithë punës dhe qenies së tij dhe të jepem ty, o Trini e Perëndisë, Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë në besim, bindje, përulje me anë të pohimit serioz: Se do të mbetem besnik deri në fund të jetës. Amen.“*

Masthead

Autori: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zyrih/Zvicër  
Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Gjermani  
Editori: Peter Johanning

A photograph of three men in dark suits and ties walking through a crowd. They are smiling and appear to be in a public setting. The background is slightly blurred, showing other people.

# Pasqyra

- 01.04.2018 Nottingham (Britani e Madhe)
- 08.04.2018 Karlsruhe (Gjermani)
- 15.04.2018 Toronto (Kanada)
- 22.04.2018 Trebaseleghe (Itali)
- 29.04.2018 Livingstone (Sambi)
- 10.05.2018 Trier (Gjermani)
- 20.05.2018 Uashington, D.C. (USA)
- 03.06.2018 Ostermundigen (Svizër)
- 10.06.2018 Luanda (Angola)
- 17.06.2018 Lajpzig (Gjermani)
- 24.06.2018 Landshut (Gjermani)

New Apostolic Church  
International

